

Sindikatat paralajmërojnë se do t'i padisin për diskriminim Qeverinë dhe deputetët

Sindikatat e punëtorëve kanë paralajmëruar padi ndaj Qeverisë dhe deputetëve nëse miratohet Projektligji për punëtorët e arsimit shqip të viteve '90. Kjo, pasi po vlerësojnë se janë duke u diskriminuar për dallim nga Sindikata e Arsimit. Nga ana tjetër kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka kërcënuar se nëse Kuvendi nuk e miraton këtë projektligj, shtatori do ta gjejë arsimin në greva. Zëdhënësja e Qeverisë, Donjeta Gashi, ka thënë se miratimi i këtij projektligji ka qenë obligim moral i Qeverisë, por nuk ka komentuar paralajmërimet e sindikatave të tjera për padi e protesta

Edona Kutleshi

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Padi ndaj Qeverisë dhe deputetëve e protesta në rrugë kanë paralajmëruar disa sindikata të punëtorëve në Kosovë nëse Kuvendi miraton në lexim të dytë Projektligjin për punëtorët e arsimit shqip të viteve '90. Kjo, pasi sindikatat po konsiderojnë se Qeveria dhe deputetët i kanë diskriminuar kategoritë e tjera që kanë shërbyer në vitet '90, duke favorizuar vetëm punëtorët e arsimit.

Projektligji, i cili rregullon statusin për punëtorët e arsimit që kanë kontribuar në vitet '90, ka kaluar në leximin e parë në Kuvend më 17 maj dhe shpejt pritet të dërgohet në lexim të dytë.

Sindikatat diskriminimin po e bazojnë duke u mbështetur në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili parasheh që t'u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Blerim Sylja, ka bërë të ditur se u ka dërguar letër kryeministrit dhe të gjitha grupeve parlamentare për atë që mund t'i presë nëse miratohet ky projektligj.

"Ne e kemi shpjeguar se ekziston Ligji mbi skemat pensionale ku në mënyrë specifike ceket se iu njihet stazhi të gjithë punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve. Unë kam apeluar edhe tek Parlamenti që ose të aprovojë ligj për të gjithë, ose do të kemi probleme gjyqësore. Ne do ta

për diskriminim, sepse Kushtetuta të gjithëve na njeh njëjtë", është shprehur Sylja.

Ai ka theksuar se nuk janë kundër që të ketë ligj për punëtorët e arsimit, por që nuk duhet të ketë favorizime ndaj asnjë sindikate. I pyetur për numrin e punëtorëve shëndetësorë të viteve '90, Sylja ka thënë se nuk e di pasi, sipas tij, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës nuk ka mbajtur evidenca të sakta.

E kryetari i Federatës Sindikale të Administratës Publike (SPAK), Ndue Kalaj, e ka quajtur për keqardhje që Qeveria tash e 19 vjet nuk e ka rregulluar stazhin e punës për punëtorët e administratës të cilët, sipas tij, nuk i pranuan masat e dhunshme dhe okupimin nga Serbia.

Nëse miratohet Projektligji për punëtorët e arsimit të viteve '90, ai ka thënë se do ta ndiejnë veten të diskriminuar. Madje ka paralajmëruar edhe protesta para Qeverisë së Kosovës.

"E konsiderojmë si diskriminues nëse miratohet ky projektligj dhe e dimë se kjo bëhet për poenë politike, për shkak se në arsim kanë shumë vota. Arsimit po ia kompensojnë punën, kurse nëpunësve të shtetit të cilët punuan nën regjimin serb jo. Kjo kategori po dëmtohet", është shprehur Kalaj.

Favorizimi i një kategorie dhe anashkalimi i të tjerave të së njëjtës periudhë, sipas tij, është një padrejtësi nga ana e shtetit.

"Do t'i njoftojmë edhe ambasadorët se si mund të lejojnë të nxjerrin ligje diskriminuese me të cilat Kosova i dënon qytetarët e vet dhe

Ndërkaq nënkryetari i Sindikatës së Policisë, Shaban Tasholli, ka kërkuar që kontributi i viteve '90 t'u njihet të gjitha kategorive njëjtë e jo të ketë dallime mes kategorive.

"Nuk e di kush kanë qenë ata njerëz që e kanë aprovuar atë ligj, sepse ne në vitin 1990 e kemi lëshuar punën dhe kemi punuar paralel me pushtetin serb nën urdhrat e Qeverisë së Kosovës. Nuk ka polic që nuk është bastisur, rrahur e maltretuar. Ne jemi të diskriminuar dhe duam të ketë projektligj edhe për neve", ka theksuar Tasholli.

Deklaratat e sindikatave të tjera, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, i ka quajtur të padrejta.

Sipas tij, mësimdhënësit më shumë se kushdo tjetër e meritojnë të shpërblehen për punën që kanë bërë në vitet më të vështira për Kosovën.

"Në vitet '90 i vetmi sektor që i ka thënë jo Serbisë dhe ka punuar me planet e Kosovës kanë qenë mësimdhënësit. Ata janë rrahur dhe maltretuar dhe kanë punuar duke i mbajtur shkollat hapur. Prandaj nuk është e ndershme që të reagojë në këtë mënyrë", është shprehur Jasharaj.

Nëse deputetët nuk e miratojnë Projektligjin për punëtorët e arsimit shqip të viteve '90, kryetari i SBASHK-ut ka paralajmëruar se shtatori do të nisë me greva në arsim.

"Nëse deputetët ndikohen nga të tjerët ne s'kemi zgjidhje tjetër përveç të ndërmarrim veprime sindikale. Pra, viti i ri shkollor nuk do të fillojë", ka shtuar Jasharaj.

shqip të viteve '90 shumë shpejt pritet të dalë në debat publik për t'u diskutuar.

Kryetari i Komisionit parlamentar për arsim, Ismajl Kurteshi, ka bërë të ditur se pas vërejtjeve dhe sugjerimeve Projektligji do të dërgohet në Kuvend.

"Pas debatit ku merren vërejtjet dhe sugjerimet do ta shqyrtojmë Projektligjin nën pas nëni. Në parim jemi për t'ua njohur meritat atyre që kanë kontribuar gjatë viteve '90 në arsim, mirëpo duhet të merren parasysh edhe të tjerët që kanë kontribuar, por edhe mundësitë e buxhetit, sepse nuk jemi për t'i krijuar buxhetit probleme të patejkalueshme", është shprehur Kurteshi.

Më 17 maj, kur Kuvendi e ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për punëtorët e arsimit shqip të viteve '90, ministri i Financave, Bedri Hamza, u ka bërë thirrje epitetëve që të kenë kujdes në ruajtjen e stabilitetit makrofinansial të vendit.

Ai pati shprehur shqetësim se nuk e dinë si do të mundë t'i qëndrojnë presionit të kategorive të tjera nëse miratohet ky projektligj.

Gazeta ka tentuar të marrë një qëndrim nga Hamza rreth pakënaqësive të sindikatave dhe paralajmërimit për padi e protesta, por nuk ia ka dalë të vërë kontakt.

Nga ana tjetër zëdhënësja e Qeverisë, Donjeta Gashi, ka thënë se Projektligji për punëtorët e arsimit të viteve '90 është veprim i nevojshëm dhe ka qenë obligim moral ndaj kontributit të tyre.

"Qeveria është e përkushtuar që t'u gjejë zgjidhje shumë problemeve

të cilat marrin kohë", ka thënë shkurt ajo.

Ditë më parë Instituti GAP ka nxjerrë një dokument ku ka vlerësuar se Projektligji për punëtorët e arsimit shqip për periudhën 2018-2020 do t'i kushtojë buxhetit të shtetit 30.4 milionë euro, ose 16.1 milionë euro më shtrënjtë sesa është llogaritur nga Ministria e Financave.

GAP-i ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që të kthejë mbrapa në Qeveri këtë projektligj dhe ta obligojë Qeverinë që të hartojë ligj të ri për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Ky institut i ka rekomanduar Kuvendit që të kërkojë nga Ministria e Financave një vlerësim të ri të ndikimit financiar, duke përfshirë edhe të dhënat e sakta për numrin e mësimdhënësve që do të pensionohen çdo vit.

Më 12 shkurt të këtij viti, Ministria e Financave ka nxjerrë një opinion rreth vlerësimit financiar të Projektligjit për mësimdhënësit e viteve '90. Në këtë opinion thuhet se kostoja e këtij projektligji për vitet 2018-2020 është 16.757.476.50 euro.

Sipas dokumentit, nëse do të miratohet Projektligji, për vitin 2018 duhen 2.514.697.50 euro, për vitin 2019 duhen 6.738.678.00 euro dhe për vitin 2020 duhen 7.504.101.00 euro.

Në vitin 2018 do të përfitonin 9.656 punëtorë arsimorë, që aktualisht janë në pension, në vitin 2019 do të përfitonin 10.808 punëtorë arsimorë, kurse në vitin 2020 do të përfitonin 12.045 mijë punëtorë të arsimit.